

KOMISIONI EVROPIAN



Štefan Füle

Komisioner për Zgjerim dhe Politikë të Fqinjësisë Evropiane

Bota që kërkojmë: të drejtat dhe liritë e fëmijëve

Check Against Delivery
Seul le texte prononcé fait foi
Es gilt das gesprochene Wort

Konferencë e Nivelit të Lartë për Drejtësinë e Fëmijëve në Evropë dhe në Azi Qendrore/Bruksel

27 qershor 2013

Zonja dhe zotërinj,

Kam nderin t'u dëshiroj mirëseardhje në Konferencën e Nivelit të Lartë për Drejtësinë e Fëmijëve, e cila u organizua bashkërisht nga Bashkimi Evropian dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë (UNICEF). Kjo është një pjesë e mbështetjes sonë të vazhdueshme për vendet fqinje dhe ato që janë të inkuadruara në procesin e zgjerimit, për themelimin dhe reformimin e sistemeve të tyre gjyqësore për të rinj. Është gjithashtu edhe një reflektim i faktit se ne kujdesemi për fëmijët tanë, në fakt, për të gjithë fëmijët.

Para se të marrim parasysh situatën aktuale dhe ajo që duhet bërë në të ardhmen, më lejoni të theksoj angazhimin tim të fuqishëm për implementimin e politikës së Bashkimit Evropian në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Kjo vlen për bashkëpunimin e përfunduar me autoritetet nacionale dhe shoqërinë civile, kështu që ne mund të garantojmë se fëmijët janë të trajtuar si anëtarë me të drejta të plota në shoqëri.

Ekzistojnë edhe shumë sfida të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e Fëmijës dhe Gjyqësinë e të Rinjve përbrenda BE-së. Në fakt, në vitet e fundit, BE-ja ka miratuar disa pjesë të legjislacionit relevant për fëmijët në gjyqësi – për shembull direktiva mbi keqpërdorimin dhe eksploatimin seksual, direktiva kundër trafikimit, - dhe tani planifikojmë të propozojmë një masë të re për të dyshuarit / të pandehurit.

Pjesëmarrja e vendeve të zgjerimit në këtë proces është shumë relevante, ngaqë tema e konferencës së sotme është fushë prioritare për BE-në në procesin e anëtarësimit. Vërtetë, 'acquis' e BE-së për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës nuk është kufizuar vetëm në kapitullin 23 – Gjyqësia dhe të drejtat fundamentale. Jo më pak se 17 kapituj të tjerë të 'acquis' përmbajnë instrumente ligjore që kanë dispozita të rëndësishme për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Përkundër progresit të pakët, ekziston akoma hapësirë për përmirësim të dukshëm, kur bëhet fjalë për të drejtat e fëmijëve. Këtu mendoj sidomos për nevojën e tejkalimit të institucionalizimit të të drejtave të fëmijëve dhe nxitjen e mekanizmave promovues në përkrahjen e familjeve.

Shqetësimet tona nuk mbarojnë këtu. Më lejoni të përmendi gjashtë fusha të tjera me rëndësi, të cilat duhen trajtuar:

- mungesa e dhënies së prioritetit për të drejtat e fëmijëve në proceset gjyqësore penale;
- mungesa e objekteve të përshtatura që korrespondojnë me nevojat specifike të të rinjve në paraburgim;
- ndihmë e pamjaftueshme ligjore pa pagesë për fëmijë;
- reagime represive ndaj ofendimit të të rinjve;
- mungesë e alternativave efektive për paraburgim dhe përdorim i tepruar i paraburgimit; dhe
- mungesë e masave specifike për viktimat fëmijë, gjë që shkakton traumë të panevojshme dhe ri-viktimizim.

Prandaj, është shumë me rëndësi që vendet fqinje dhe ato që janë në procesin e zgjerimit, jo vetëm t'u përmbahen standardeve ndërkombëtare për të drejta të njeriut, por gjithashtu duhet të garantojnë implementimin efektiv të legjislacionit të të drejtës penale, të miratuar pak kohë më parë, i cili në disa vende është shumë i avancuar.

Përkrahja për reformën gjyqësore është një nga shtyllat themelore të veprimeve të jashtme të Bashkimit Evropian. Ajo ka për qëllim:

- të sigurojë pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin gjyqësor;
- të shtojë performancën, efikasitetin, përgjegjësinë dhe transparencën e sektorit gjyqësor;
- përmirësimin e qasjes në drejtësi për më të varfërit dhe më të cënueshmit; dhe

- përmirësimin e kushteve të paraburgimit dhe prezantimin e alternativave të burgosjes.

Iniciativat e suksesshme të reformës gjyqësore janë ato që ndërtohen në prioritetet nacionale, të cilat gëzojnë angazhim të plotë politik dhe pronësi nacionale, si dhe partneritete të forcuara mes shoqërisë civile dhe vendim-marrësve shtetërorë.

Dëshiroj t'ua përkujtoj mbështetjen e filluar që e ofron Komisioni Evropian në vendet fqinje dhe të zgjerimit:

Në vendet fqinje, Komisioni mbështet reformën gjyqësore për të rinjtë, në suaza të agjendës së sundimit të ligjit në Ukrainë, Gjeorgji, Moldovë, Azerbejxhan dhe Armeni, përmes ndihmës financiare dhe teknike të ofruar nga Instrumenti për Fqinjësi dhe Partneritet Evropian.

Në vendet e zgjerimit, Komisioni ka ofruar mbështetje përmes Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësuese, për të përforcuar masat e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi dhe për të mbështetur ndihmën e viktimave fëmijë (p.sh. në Kroaci, në kontekst të keqpërdorimit seksual) dhe veçanërisht sistemeve gjyqësore për të rinj (p.sh. në Kosovë, Mal të Zi, ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Turqi). Është ofruar edhe mbështetje për shoqërinë civile që punon në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Vendet e zgjerimit gradualisht janë duke harmonizuar legjislacionin e tyre me 'acquis' e BE-së. Komisioni mbikqyr intensivisht këtë proces, duke përfshirë edhe atëherë kur bëhet fjalë për të drejtat e fëmijës në kapituj të ndryshëm. Në këtë drejtim, dua të theksoj se grumbullimi i të dhënave është një pjesë e rëndësishme e kësaj pune monitoruese. Komisioni Evropian mbështet vendet e zgjerimit dhe fqinjësisë, për të përforcuar kapacitetin e tyre statistik, në mënyrë që të ketë në dispozicion të dhëna të besueshme që përkrahin politikë-bërjen moderne.

Ne mbetemi të angazhuar në mbështetjen e projekteve dhe politikave që përmirësojnë sistemet e mbrojtjes së fëmijës dhe forcojnë të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë situatat e të qenit viktimë ose në kontekstin e proceseve gjyqësore.

Duke pranuar faktin se reforma gjyqësore për të rinjtë është pikë hyrëse kryesore për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbështetja e deritanishme e BE-së për avancimin e agjendës së reformave në gjyësinë për të rinj është fokusuar në dy fusha:

E para, reforma e ligjit për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sidomos me anë të:

- Inkurajimit dhe përkrahjes së dekretit dhe rishqyrtimit të legjislacionit nacional për të siguruar përputhshmërinë e tij me standarde relevante ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës, në veçanti Konventën për të Drejtat e Fëmijës; dhe
- Përmirësimit të kapacitetit të agjencive që zbatojnë ligjin për hetimet e shkeljes së të drejtave të fëmijëve dhe zhvillimin e procedurave të pranueshme për fëmijë në procedurat paragjyqësore dhe gjatë gjykimit.

E dyta, luftimi dhe shkeljet dekurajuese për të drejta të fëmijëve, sidomos me:

- Ndalimin e shkeljes të të drejtave të fëmijës dhe keqtrajtimin e fëmijëve në drejtësi, duke përfshirë të drejtën penale, si dhe duke i dhënë fund mosndëshkimit të shkeleve të të drejtave të fëmijës; dhe
- Marrja e masave efektive legjislative, administrative, gjyqësore dhe masave të tjera për parandalimin e të drejtave të fëmijës nën jurisdikcionin e Shtetit, si dhe luftimin e mosndëshkimit për shkeljet e këtilla.

Ne nuk punojmë vetëm. UNICEF-i është një nga partnerët tanë tradicionalë, puna themelore e të cilit është duke i avancuar të drejtat e fëmijëve, në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe përvojat më të mira. Krenohem sidomos me bashkëpunimin që kemi themeluar me UNICEF-in, për të përballuar konsekuencat e krizës së Sirisë. Pak kohë më parë, kur isha në Jordani, shkova në kampin e refugjatëve Zaatari dhe inaugurova një shkollë të udhëhequr nga UNICEF-i dhe të financuar nga Komisioni Evropian. Me anë të këtij bashkëpunimi konkret, fëmijëve që jetojnë në kampe u mundësojmë të kenë një jetë që ngjason me jetën normale dhe mundësinë për të fituar njohuri që do të rindërtojnë jetët e tyre.

Me anë të qasjeve inovative, hulumtimit, shkathtësive dhe përfshirjes së vazhdueshme, UNICEF-i ka dhënë kontribut të madh në këshillimin e vendeve për mënyrën e reformimit të sistemeve të tyre gjyqësore për të rinj, në bazë të legjisllacionit, politikave dhe operacioneve moderne.

Sot kemi mundësinë të flasim për arritjet tona, por edhe për atë që duhet bërë dhe si duhet bërë, në mënyrë që fëmijët të gëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre, kurse shtetet të mund të reagojnë në mënyrë adekuate ndaj kërkesave dhe pritjeve të tyre.

Kjo është bota që ne po e kërkojmë. Është në interesin tonë të përbashkët dhe është qëllimi ynë i përbashkët. Fëmijët meritojnë këtë dhe asgjë më pak.